



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Flamuri V shpk” të datës 22.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Flamuri V shpk” të datës 22.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Flamuri V shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 22.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Tenderuesi i rekomanduar për kontratë GOE "GEB sh.p.k & Harst Group sh.p.k." kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk kanë përmbushur kërkesat e DT si në vijim:

1. Në DT përcaktohet që OE duhet të dorëzojnë një listë të stafit të nënshkruar dhe vulosur ku duhet të prezantohen të dhënat vijuese: emri, mbiemri, **mosha**, profesioni, poz. në kompani. Ndërsa tenderuesi i rekomanduar konkretisht lideri i GOE ka prezantuar një listë e cila nuk është e formuluar sipas DT për arsye se në listë nuk evidentohet fare mosha e punëtorëve sipas DT.

2. Në DT është kërkuar nga OE që të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të punëve të ngjashme në tri (3) vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë jo më pak se 117,900.00 euro. Dëshmia e kërkuar: Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar **Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit** ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkangjiten kontratat dhe referencat ose raportet për kryerjen e punimeve.

- Tenderuesi i rekomanduar ka përdorur një formular tjetër për të prezantuar listën e kontratave. Konkretisht tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar aneksin 6 (që në DT i referohet kriterëve të dhënies) dhe jo aneksin 7 sikurse është kërkuar me DT.

3. Tenderuesi i rekomanduar nuk e ka plotësuar në mënyrë të plotë Deklaratën nën Betim. Konkretisht te pjesa e adresës nuk është treguar në cilin qytet e ka selinë lideri i GOE.

4. Përmes DT kërkohej të përcaktohen afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës: në 50 ditë. Ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar një plan dinamik i cili nuk është në përputhje me DT duke qenë se i ka dy kuptime dhe ka kundërthënie përbrenda. Më konkretisht, te përshkrimi i planit dinamik përcaktohet afati prej 30 ditëve të punës ndërsa kolona përkatëse në plan dinamik i ka vetëm 20 ditë. Pra plani dinamik nuk është i saktë.

5. Në DT te pjesa e kërkesave për pajisje dhe makineri, lideri i GOE ka prezantuar disa marrëveshje për marrjen e makinerisë me qera. Mirëpo këto marrëveshje nuk e kanë evidentuar se cilat pajisje konkretisht janë marrë me qera. Pra mungojnë objektet e kontratave. Rrjedhimisht këto marrëveshje nuk janë të plota. Për këtë arsye marrëveshjet e tilla me Niki-GD shpk, Burimi E shpk, ERST Bau shpk dhe KAB Holding shpk nuk mund të merren parasysh nga AK. Për këto arsye tenderuesi i rekomanduar nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e DT lidhur me pajisjet dhe makinerinë.

Parashtruesi ka prezantuar argumente sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar kontrata për marrjen me qera të makinerisë mirëpo nuk ka specifikuar makineritë që janë objekt i kontratave. Kjo përbën shkelje sepse cdo kontratë e qeramarrjes duhet të ketë objektin e specifikuar që i referohet aktivitetit përkatës të prokurimit. Po ashtu ka prezantuar argumente sipas të cilave ka mospërputhje përbrenda planit dinamik ashtu që te kolonat përkatëse të planit janë ofertuar vetëm 20 ditë ndërsa te përshkrimi prezantohen 30 ditë. Po ashtu janë prezantuar argumente sipas të cilave nuk është përmbushur as kërkesa për kontrata/referenca për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit jo më pak se 117,900.00 euro. Po ashtu edhe sa i përket plotësimit të deklaratës nën betim si dhe listës së stafit, parashtruesi ka prezantuar pretendime ankimore me argumente konkrete. Sa i përket pretendimit për deklaratën nën betim, është gjetur se kjo mund të përbën devijim të vogël prandaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimet tjera janë gjetur si të bazuara në parim mirëpo duhet të konfirmohen nga komisioni për rivlerësim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.07.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.